

NJOFTIM MBI ZGJATJEN E AFATIT PËR DORËZIM TË OFERTAVE

*Procedurë e hapur
Shërbim*

Në përputhje me nenin 25, të Rregullës së Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

I. BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, BQK,
Adresa: Rr. “Luan Haradinaj ” nr.2, 10000 Prishtinë

II. Njoftim nga BQK për operatorët ekonomik për zgjatje të afatit për dorëzim respektivisht hapje të ofertave

III. Data: 28.05.2026

IV. Lënda e kontratës:

IV.1 Titulli i kontratës: “Sigurimi i jetës në grup”

IV.2 Numërtimi i prokurimit: “BQK 26 037 221”

V. Zgjatja e afatit për dorëzim dhe hapje të ofertave:

Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit dhe informata të tjera:

V.1. Afati i fundit pas zgjatjes për sqarime dhe tërheqje të dosjes së tenderit: 02.06.2026 ora 14:00 në e-mail adresën: prokurimi@bqk-kos.org.

V.2. Afati i fundit pas zgjatjes për dorëzim të ofertave: **04.06.2026, ora 14:00.**

V.3. Takimi për hapjen e ofertave pas zgjatjes: **04.06.2026, ora 14:30.**

Vendi: Objekti i BQK-së, Rr. “Luan Haradinaj” nr.2.

VI. Arsyeja e zgjatjes së afatit:

Zgjatja e afateve kohore për tërheqjen e dosjes së tenderit, dorëzimit dhe hapjes së ofertave ndërlidhet me mungesën e interesimit të operatorëve ekonomik për tërheqje të dosjes së tenderit. Si rrjedhojë, sipas nenit 25, paragrafit 7 të Rregullës së Prokurimit, Banka Qendrore bënë zgjatjen e afateve kohore për t’ju ofruar operatorëve ekonomik

kohë të mjaftueshme për përgatitjen e tenderëve dhe dorëzimin e ofertave të tyre, gjithmonë duke i zbatuar parimet e përgjithshme të prokurimit, publicitetin, transparencën, mos-diskriminimin, trajtimin e barabartë dhe konkurrencën e drejtë.

VII. Ankesat

Në përputhje me nenin 48 të Rregullës për Prokurimin në BQK, palët e interesuara mund të parashtrorjnë ankesë brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa nga pala e interesuar duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivin e BQK-së brenda afatit për t'u konsideruar e vlefshme. Pala ankuese duhet të paguajë një tarifë për parashtrim të ankesës pranë Bankës Qendrore, vlera e së cilës do të jetë deri në 1% të vlerës së ofertës përkatëse, jo më pak se 100 euro dhe jo më shumë se 2,500 euro. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së. Ankesa e parashtruar pa dëshminë e pagesës që duhet të sigurohet nga pala ankuese do të refuzohet që në pranim të parë nga Banka Qendrore.

VIII. Adresa

| | |
|---|---|
| Rr. "Luan Haradinaj" nr. 2 | |
| Qyteti: Prishtinë | Kodi Postar: 10000 |
| URL: www.bqk-kos.org | |
| Personi kontaktues: Divizioni i Prokurimit dhe Kontraktimit | E-maili: prokurimi@bqk-kos.org |
| Telefoni: | 038 222 055/451 |